



## AKT THEMELIMI

### SHOQERIA ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR "MUZA" sh.p.k.

Ky Akt themelimi, që u përpilua ndërmjet:

- Gëzim Zajmi i biri i Bajramit datëlindja 12/4/1957, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë Rr. "Qemal Stafa" Pall. 195, sh. 2, ap. 22. Nr. i letërnjoftimit UG 039036.
- Abaz Muça i biri i Xhemalit datëlindja 10.7.1942, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë, Rr. "Mujo Ulqinaku" nr. 45. Nr. i letrës së njoftimit AZ 051747.

Të quajtur më poshtë Asamble ortakësh, në përputhje me Ligjin me nr. 7632, datë 4.11.1992. "Për dispozitat që rregullojnë pjesën e parë të Kodit Tregtar", me Ligjin nr. 7638, datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare" si dhe në akte të tjera të legjislacionit, vendosën të hartojnë këtë akt themelimi si vijon:

#### I - FORMIMI

##### 1.1 FORMIMI I SHOQERISE

Ortakët Gëzim Zajmi dhe Abaz Muça formojnë një Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me kreun e katërt të Ligjit nr. 7638 datë 19.11.1992 "Për Shoqëritë Tregtare".

##### 1.2 - EMERTIMI I SHOQERISE

Emërtimi i Shoqërisë do të jetë "Muza" sh.p.k.

##### 1.3 OBJEKTI I SHOQERISE

Objekti i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë "Muza" sh.p.k është si vijon:

- Shtypshkrimi i veprave letraro artistike, me pakicë dhe shumicë, reklamave, revistave kartoline, etiketave, gazetave, formularëve të ndryshëm, dhe prodhime të ndryshme tipografie.
- Tregtimin me shumicë dhe pakicë të materialeve tipografike. (letër bojë, lastra, kimikate, etj)
- Konsulencë tregtare, financiare, administrative, dhe logjistike, përfaqsim legal në fushën e shtypshkrimeve të shtetasve të huaj që kryejnë aktivitet të ligjshëm në Shqipëri.

##### 1.4- SELIA E SHOQERISE

Selia e qendrore e përkohshme e Shoqërisë do të jetë në Tiranë Rr. "Çerçiz Topulli" nr.33. Me vendim të Asamblesë së ortakëve mund të hapen degë, zyra, filiale ose përfaqësi të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë saj.

##### 1.5 - AFATI I SHOQERISE

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë mbi 20 vjet. Si ditë fillestare do të merret data e regjistrimit të saj në Gjykatën e Tiranës. Asambleja e ortakëve ka të drejtë ta zgjasë këtë afat.

##### 1.6 - RUAJTJA E SEKRETIT

Asambleja e ortakëve si dhe persona të tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakort që mos t'i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë si dhe planet dhe qëllimet e saj për të ardhmen.

## II - KAPITALI

### 2.1 - KAPITALI

Kapitali themeltar është 100 000 lekë dhe ndahet në këtë mënyrë:

1. Gëzim Zajmi 50%.
2. Abaz Muça 50 %.

Kapitali themelor do të jetë kontribut në para dhe është i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

### 2.2 - KONTRIBUTET E KAPITALIT

Sasia e kapitalit të derdhur sipas pikës 2.1 të këtij akti themeltar do të quhet "KONTRIBUT" kapitali, kontribut ky i të dy ortakëve në masën 50% për secilin ortak.

KONTRIBUTI I KAPITALIT fillimisht do të përdoret për shpenzimet fillestare të Shoqërisë.

Asambleja e ortakëve ka të drejtë ti bëjë shtesë kapitalit të saj.

### 2.3 FITIMI

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i shoqërisë do të ndahet midis ortakëve me pjesët e vë na në kapitalin themeltar, pra:

1. Ortaku Gëzim Zajmi do të marrë 50 përqind të fitimit të realizuar.
2. Ortaku Abaz Muça do të marrë 50 përqind të fitimit të realizuar.

### 2.4 - FINANCIMI

Për aq sa do të jetë e mundur Shoqëria ka të drejtë të sigurojë financim tregtar ose investues nga çdo bankë apo institucion financiar (i huaj apo shqiptar), financim që do të rregullohet me anë të kontratave apo marrëveshjeve të posaçme me miratimin e Asamblesë së ortakëve.

### 2.5 - ÇESHTJET FINANCIARE DHE LLOGARIA E SHOQERISE

Shoqëria do t'i mbajë llogaritë duke u mbështetur në monedhën shqiptare dhe në valutat e forta. Për këtë arsye ajo, në bankën me të cilën do të operojë do të ketë dy llogari rrjedhëse, një të monedhë shqiptare (lekë) dhe në tjetrën me vautë të fortë të huaj (si dollarë amerikanë, markë gjermane, lireta italiane, sterlina angleze, etj).

Shoqëria do të ketë si vit fiskal vitin kalendarik.

## III. STRUKTURAT JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### 3.1 - ORGANET E SHOQERISE

Organet e Shoqërisë janë:

- Asambleja që përbëhet prej ortakëve themeluesë.
- Administrator i cili do të jetë ortakë Gëzim Zajmi.
- Ekspert kontabël.

**3.2 -** Secili ortak deri në ndërtimin e shoqërisë do të përballojë shpenzimet që i takojnë. Shpenzimet e mëtejshme që lidhen me aktivitetin e shoqërisë, do të ngarkohen shoqërisë mbi bazën e kritereve dhe modaliteteve të përcaktuara ndërmjet ortakëve me marrëveshje të veçantë.

**3.3 -** Të gjitha komunikimet ndërmjet ortakëve, si dhe ndërmjet përfaqësuesve të ortakëve të shoqërisë do të kenë vlerë në rast se do të komunikohen me letra rekomande, telegrame, telekse, telefakse ose dorazi. Vendimet e marra nga Asambleja do të kenë vlera pasi të noterizohen.

**3.4 -** Kompetencat e Asamblesë së ortakëve, administratorit dhe ekspertit kontabël, përcaktohen në Statut.



#### IV DISPOZITE E FUNDIT

**4.1** Ndryshimet në këtë AKT mund të bëhen vetëm me shtesë me shkrim dhe të miratuara nga themeluesit.

Pjesë e pandarë e këtij AKTI është statuti i Shoqërisë i cili nënshkruhet njëkohësisht nga themeluesit e Shoqërisë.

**4.2** Ky AKT themelimi i hartua në Tiranë në katër ekzemplar origjinalë duke patur secili prej tyre të njëjtën vlerë.

#### THEMELUESIT

**GEZIM ZAJMI**



**ABAZ MUÇA**



REPUBLICA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 267 Rep.

Nr. 262 Kol.

## VERTETIM

Sot më datë 24/2/1997 (nëntëdhjetëeshtatë) u paraqin personalisht Abaz Muça dhe Gëzim Zajmi të panjohur prej meje për identitetin e të cilëve u sigurova prej pashaportave të tyre me Nr. AZ 051747 dhe UG 039036, madhorë dhe me zotësi të plota juridike për të vepruar, të cilët deklaruan se kanë redaktuar jashtë kësaj zyre këtë Akt Themelim dhe me vullnetin e tyre të lirë e firmosën përpara meje, dhe unë Noteria e vërtetoj sipas ligjit.

NOTER

*Salih T. ves*





# **STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "MUZA" sh.p.k.**

## **KREU I FORMA, EMERTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHEZGJATJA**

### **NENI 1 FORMA**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Muza" sh.p.k., më poshtë e quajtur shoqëri, formohet nga ortakët themelues.

1. Gëzim Zajmi i biri Bajramit i datëlindjes 12/4/1957 lindur dhe banues në Tiranë Rr. "Qemal Stafa" Pall. 195 shk. 2 ap. 22, Nr. i letërës së njoftimit UG 039036

2. Abaz Muça i biri i Xhemalit datëlindja 10.7.1942, lindur dhe banues në Tiranë, me adresë, Rr. "Mujo Ulqinaku" nr. 45. Nr. letrës së njoftimit AZ 051747.

-Shoqëria krijohet në përputhje me Ligjin Nr. 7637 dt. 4/11/1992 dhe ligjin Nr. 6738, datë 19/11/1993 dhe njihet si person juridik pasi regjistrohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

### **NENI 2 EMERTIMI I SHOQERISE**

Emërtimi i shoqërisë do të jetë "**Muza**" sh.p.k.

### **NENI 3 SELIA E SHOQERISE**

Selia qendrore e shoqërisë do të jetë në Tiranë me adresën: Rr. Çerçiz Topulli, Nr. 33.

Me vendim të Asamblesë së ortakëve mund të hapë degë, zyra, filiale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë saj.

### **NENI 4 KOHE ZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria do të ketë kohëzgjatje mbi 20 vjet, si datë fillestare merret data e regjistrimit të saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

### **NENI 5 OBJEKTI SHOQERISE**

Objekti i shoqërisë do të jetë:

- Shtypshkrimi i veprave letraro artistike, me pakicë dhe shumicë, reklamave, revistave kartoline, etiketave, gazetave, formularëve të ndryshëm, dhe prodhime të ndryshme tipografike.
- Tregtimin me shumicë dhe pakicë të materialeve tipografike. (letër bojë, lastra, kimikate, etj)
- Konsulencë tregtare, financiare, administrative, dhe logjistike, përfaqsim legal në fushën e shtypshkrimeve të shtetasve të huaj që kryejnë aktivitet të ligjshëm në Shqipëri.



## KREU II

### **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, PJESET E KAPITALIT THEMELTAR DHE TRANSFERIMET**

#### NENI 6

#### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 000 lekë.

- Zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit themeltar të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së ortakëve.

- Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë.

#### NENI 7

#### **KONTRIBUTET**

- Kapital themeltar është paguar nga të dy ortakët respektivisht nga 50 000 lek.

#### NENI 8

#### **NDARJA E FITIMIT**

Fitimi i realizuar nga aktiviteti i Shoqërisë ndahet midis ortakëve në masën 50%.

#### NENI 9

#### **LINJA E TRANFERIMIT TE PJESEVE TE KAPITALIT**

Kapitali themeltar është lirisht i tranferushëm tek personat e tretë nëqoftëse Asambleja e ortakëve vendos për këtë. Gjithashtu ato janë lirisht të transferushëm në rast ndarje pasurore midis bashkëshortëve si dhe në rrugë trashëgimie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me Akt noterial.

## KREU III

### **STRUKTURA JURIDIKE, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

#### NENI 10

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve e cila përbëhet prej ortakëve themelues.
- Administratori i cili do të jetë ortaku i shoqërisë z. Gëzim Zajmi.
- Ekspertët kontabël.

#### NENI 11

#### **ASAMBLEJA E ORTAKEVE**

Asambleja e ortakëve përbëhet prej anëtarëve themelues. Ajo miraton raportin e administrimit, inventaret dhe llogaritë vjetore, pas mbylles së vitit financiar. Këto dokumente si dhe raporti i ekspertit kontabël u komunikohen ortakëve dhe vihen në dispozicion të tyre në selinë e shoqërisë, 15 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë. Gjithashtu Asambleja merr vendim për ndryshimet e Statutit, zmadhimin e kapitalit me anë të kontributeve në natyrë dhe me anë të kontributeve në para,

zvogëlimin e kapitalit, emëron ekspertin kontabël, shndërrimin e shoqërisë në një formë tjetër, punësimin e punonjësve dhe pagat konform legjislacionit në fuqi. Ortakët mund ti delegojnë kompetencat e tyre.

Vendimet e Asamblesë merren pas konsultimit me shkrim të ortakëve, në rast se të dy ortakët miratojnë me shkrim përmbajtjen e konsultimit. Ortakët lajmërohen me letër rekomande të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Në këtë letër njoftohet rendi i ditës. Lajmërimi bëhet nga administratori, ose në mungesë të tij nga eksperti kontabël i autorizuar.

Çdo ortak mund të kërkojë ligjërisht caktimin e një mandatmbajtësi të ngarkuar për thirrjen e Asamblesë dhe caktimin e rendit të ditës. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendime dhe disponon një numër votash të barabartë me pjesët e kapitalit themeltar që ai zotëron. Secili ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në rast se nuk merr pjesë vetë në mbledhje.

Në mbledhjet e Asamblesë ose në konsultimet me shkrim vendimet merren nga ortakët. Në rast se ortakët nuk bien dakort, atëhere konsultohen për herë të dytë, në qoftëse dhe për herë të dytë nuk bien dakort për marrjen e vendimev, atëhere vota e administratorit ortak (ose e administratorit jo ortak) është primare.

## NENI 12

### FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE

Fusha e autoritetit të ortakëve dhe përqindja e fitimeve ose humbjet do të kenë si kriter bazë kapitalin e shoqërisë, si dhe kompetencat që gëzon në marrjen e vendimeve të çdo karakteri të përcaktuar në këtë Statut.

## NENI 13

Të gjitha aktet dhe dokumentet që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si dhe letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e tjera duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet sh.p.k. dhe emrin e administratorit.

## NENI 14

### ADMINISTRIMI

Shoqëria administrohet nga administratori ortak z. Gëzim Zajmi

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit me interes të shoqërisë dhe nënshkrimin në emër të shoqërisë të të gjitha akteve në marrëdhënie me të tretët. Administratori ka të gjitha kompetencat përjashtuar kompetencat e Asamblesë të cilat janë parashikuar shprehimisht në këtë Statut dhe në ligj.

Në rast se zgjerohet aktiviteti i shoqërisë, si dhe në rast që ortaku që kryen funksionin e administratorit, nuk dëshiron ta kryejë këtë funksion, merret vendim për emërimin e një ose më shumë administratorëve të tjerë. Në këtë rast emërimi do të bëhet me një afat prej tre vitesh financiare, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose shkarkimi të parakohshëm.

Në rast të emërimit të administratorit jo ortak, ai në marrëdhënie me ortakët dhe të tretët ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet veprimeve që janë në përputhje me objektin e shoqërisë, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe statuti ia japin shprehimisht Asamblesë së ortakëve.

Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë dhe të tretëve për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit ose faje të kryera gjatë administrimit të tij.

## NENI 15

### EKSPERTI KONTABEL

Ortakët mund të emërojnë një apo disa ekspertë kontabël të autorizuar. Kompetencat, funksionet, detyrimet, përgjegjësit, zëvendësueshmëria, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimin e ekspertit ose të



ekspertëve të autorizuar përcaktohen në bazë të ligjit Nr. 7638, datp 19/11/1992, "Për Shoqëritë Tregtare".

## **NENI 16**

### **KONFIDENCIALITETI**

Asambleja e ortakëve, administratori si dhe persona të tjerë të pranuar në Shoqëri bien dakort që mos t'i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë Shoqëria, kontratat që ajo do të lidhë si dhe planet dhe qëllimet e saj për të ardhmen.

## **NENI 17**

### **ORGANI SINDIKAL**

Ky organizëm do të organizohet dhe do të funksionojë në bazë të ligjit shqiptar.

## **KREU IV**

### **LIBRAT E LLOGARISE, BILANCI, FITIMI, SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI**

## **NENI 18**

### **LIBRAT E SHOQERISE**

Shoqëria është e detyruar të mbajë përveç dokumentacionit kontabël që kërkon legjislacioni në fuqi edhe këto libra:

1. Libri i Shoqërisë në të cilin shënohen emrat e plotë të ortakëve, kapitali themeltar etj.
2. Libri i mbledhjes dhe i vendimeve të Asamblesë të ortakëve.
3. Libri i mbledhjes dhe i vendimeve të organit sindikal.

Dy librat e parë mbahen nën kujdesin e Asamblesë së ortakëve kurse i treti nën kujdesin e organit sindikal.

## **NENI 19**

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, EKSPERTET KONTABEL**

Çdo vit financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor.

Përgjatimisht viti i parë financiar mund të fillojë pas 1 mars 1997 dhe do të përfundojë më 31 dhjetor 1997.

Llogaritë vjetore, inventaret, rraportet mbi operacione të veçanta të hartuara nga ekspertët kontabël të autorizuar, miratohen nga Asambleja e ortakëve.

Miratimi i dokumenteve mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Veprimtaria e ekspertit ose ekspertëve kontabël të autorizuar nga Asambleja e ortakëve do të funksionojë sipas nenit 69 të ligjit nr. 7638, datë 19.11.1992.

## **NENI 20**


### **ZGJATJA E AFATIT**

Zgjatja e afatit të Shoqërisë që është përcaktuar në këtë statut mund të vendoset nga Asambleja e ortakëve.

## **NENI 21**

### **AKTIVITETI FINANCIAR**

Në çdo mbyllje të vitit financiar bëhet inventari dhe llogari vjetore në përputhje me dispozitat e







legjislacionit në fuqi për kontabilitetin, si dhe hartohet një raport me shkrim.

Bilancit i bashkangjiten:

- a. Një situacion mbi garancitë e dhëna nga Shoqëria.
- b. Një situacion mbi sigurimet e bëra nga Shoqëria.

Raporti përfshin gjëndjen gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e mundshme që janë zhvilluar nga data e mbylljes së vitit financiar deri në ditën që është hartuar ky raport.

Dokumentet vihen në dispozicion të ekspertit ose ekspertëve kontabël dhe në përfundim miratohen nga Asambleja e ortakëve.

## NENI 22

Fitime neto të Shoqërisë do të konsiderohen që rezultojnë pas zbritjes nga të ardhurat e të gjitha shpenzimeve që kanë lidhje me aktivitetin e Shoqërisë, detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore, dëmtimet, amortizimet, etj në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera të veçanta financimi.

Përbërja, shuma e përgjithshme, burimet për krijimin e fondit rezervë, përdorimi dhe rregullimi i çdo fondi të veçantë caktohet nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

Në përputhje me nenin 213 të ligjit "për shoqëri tregtare" nga fitimi i rezervuar gjatë fitit financiar lihet më një anë një shumë me vlerë 20% e cilat destinohet për formimin e një fondi "rezervë e domosdoshme".

## NENI 23

### PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria priset me kalimin e afatit të caktuar në statut dhe për arsye të përcaktuar në ligj. Shoqëria priset para afatit me vendim të Asamblesë së ortakëve.

## NENI 24

Rastet e pavlefshmërisë së Shoqërisë ose të një akti që ndryshon statutin, si dhe bashkimi i Shoqërisë bëhet me përputhje me dispozitat e ligjit për "Shoqëritë tregëtare".

## NENI 25

Kur Shoqëria priset ajo kalon në likuidim, emërtimit të dhënë të Shoqërisë me këtë rast i shtohet shënimi: "Shoqëri në likuidim e sipër". Shoqëria dhe gjatë procesit të likuidimit vazhdon si person juridik privat deri në përfundim të procesit të likuidimit.

Prishja e Shoqërisë është me pasoja ndaj të tretëve vetëm pas publikimit të prishjes në regjistrin tregtar.

## NENI 26

Për të përfunduar procesin e likuidimit, Asambleja e ortakëve emëron një ose disa persona si likuidues të cilët përfaqësojnë Shoqërinë. Likuiduesi përpilon bilancet financiare, likuidon tek të tretët detyrimet e Shoqërisë, shet aktivët e Shoqërisë dhe tepëricat i kalojnë Asamblesë së ortakëve.

Në rast se Asambleja e ortakëve nuk ka mundësi të emërojë një likuidues ai emërohet nga gjykata.

## NENI 27

Në përfundim të mbylljes së likuidimit, Asambleja e ortakëve vendos për bilancin financiar përfundimtar, për aktin e rregullueshmërisë, për administrimin e tij nga ana e likuiduesit dhe për heqjen e mandatit të likuiduesit, si dhe për tu evidencuar mbydhja e likuidimit.

Dokumentat e mësipërme miratohen nga Asambleja e ortakëve.

## NENI 28

Kur Shoqëria likuidohet pasuritë, që janë vënë në dispozicion të Shoqërisë me të drejtë shfrytëzimi, u kthehet pronarëve.

Mjetet financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së Shoqërisë dhe fondet fillestare i kalojnë Asamblesë së ortakëve pasi të jenë bërë pagesat e kreditorëve.

## DISPOZITA E FUNDIT

### NENI 29

Shoqëria ka të drejtë të punësojë punonjës që i nevojiten për të ushtruar veprimtarinë e saj. Punësimi bëhet sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin e punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe të rregullave të vëna në kontratën e veçantë të punësimit që lidhet midis punëdhënësit dhe punonjësit.

Shoqëria u garanton punonjësve kushte pune dhe mjete të nevojshme për realizimin e detyrës së kryejnë.

### NENI 30

Të gjitha problemet që do të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj Shoqërie do të zgjidhen sipas rregullave të përcaktuara në statutin dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kur mosmarrveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Tiranë.

### NENI 31

Ky statut është hartuar në katër kopje, në gjuhën Shqipe, duke pasur secila kopje të njëjtën fuqi ligjore.

### NENI 32

Ky statut firmoset nga Asambleja e ortakëve me vullnetin e tyre të lirë.

## THEMELUESIT

**GEZIM ZAJMI**



**ABAZ MUÇA**



REPUBLICA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 767 Rep.

Nr. 762 Kol.

## VERTETIM

Sot më datë 24 / 2 / 1997 (nëntëdhjetëeshtatë) u paraqin personalisht Abaz Muça dhe Gëzim Zajmi të panjohur prej meje për identitetin e të cilëve u sigurova prej pashaportave të tyre me Nr. AZ 051747 dhe UG 039036, madhorë dhe me zotësi të plota juridike për të vepruar, të cilët deklaruan se kanë redaktuar jashtë kësaj zyre këtë statut dhe me vullnetin e tyre të lirë e firmosën përpara meje, dhe unë Noteria e vërtetoj sipas ligjit.

